



Syri i Vizionit

- Nëse keni trashëguar ju probleme nga paraardhësit tuaj, mos ua leni edhe ju trashëgim pasardhësve tuaj.
- Ligjet që janë në fuqi mundësojnë regjistrimin e pronës, bazuar në dokumentacioni aktual. Regjistrimi mundëson që secila pronë të jetë në funksion të tregut të lirë, në funksion të pronarit dhe në funksion të zhvillimit ekonomik.
- Blej me letra. Prona nuk mund t'i lihet mirëbesimit. Ke shtet, ndjek ligjin.
- Për çdo gjendje ka një zgjidhje. Ligji jep zgjedhje për çdo lloj situatë. Drejtohu tek institucionet dhe hape rastin tënd.
- Zgjidhja e këtyre problemeve është e rëndësishme për t'i parandaluar konfliktet, padrejtësinë, joligjshmërinë dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.
- Regjistro pronën tënde, deli zot pasurisë tënde, mos e lë për nesër. Zgjidhe kontestin sot.

## Increasing Citizen's Awareness and Participation in the Justice System

“MBROJE  
PRONËN  
TËNDE”



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA



Ky publikim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja është përgjegjësi e organizatës “Syri i Vizionit” dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Projekti “Mbroje pronën tënde” i “Syri i Vizionit” synon të ngritë vetëdijen e qytetarëve mbi rëndësinë e zgjidhjes së çështjeve të pronës, si në kuptim të bartjes së trashëgimisë tek trashëguesit përkatës të saj, ashtu edhe në raportet me ndërrimin e pronarëve, duke e shoqëruar me dokumentacionin e duhur, duke u fokusuar kryesisht në zonat rurale dhe aty ku mungon vetëdija dhe praktikat e tilla.

Nga tradita në Kosovë, një pjesë e madhe e pronave të paluajtshme s'janë të regjistruara në emrat e pronarëve të vërtetë, me raste kur prona me dekada bartet në emrat e personave që kanë vdekur me vite. Si mentalitet i së kaluarës në familjet e mëdha, prona është regjistruar në emër të kryefamiljarit, dhe kështu është mbajtur për 3-4 breza. Edhe pse me ndarjen e familjes edhe prona është ndarë në disa pjesë, në regjistrat kadastralë ende sot prona figuron në emrin e ish kryefamiljarit, që është ndonjë gjysh që s'jeton më. Kjo krijon probleme për pasardhësit, jo

vetëm në verifikimin e pronësisë, por edhe në dokumentacionin kur ata duan të shesin apo blejnë pronën e vet, hipotekimin e saj, dhe të gjitha format e shfrytëzimit të saj.

Të njëjtin problem krijojnë edhe mungesa e dokumentacionit të shitblerjeve të pronave në 50 vjetët e fundit. Pronat janë blerë dhe shitur në mirëbesimin mes shitësit dhe blerësit, pa dokumentacion, por vetëm bazuar në dëshmitarët, që janë familjarë ose të njohur për të dy palët në rolin e garantuesit.

Kjo ka ndodhur posaçërisht në tri dekadat e fundit kur edhe ka pasur ndalesa administrative (kryesisht politike) për shitblerjen e pronave mes serbëve dhe shqiptarëve, çka i ka shtyrë shitësin dhe blerësin, që të bëjnë aktin e shitblerjes dhe dorëzimit të pronës pa e dokumentuar në gjykatat, që nuk ua kanë vërtetuar atë.

Poashtu ndodh me shitblerjet pa dokumentacion përkatës dhe pa vërtetimin në gjykatë. Kjo bën të ketë mjaft probleme mes pronarëve dhe ish pronarëve, që përfundojnë nëpër gjykata. Gjendja e tillë sot është shkaktar i një problemi të madh social, që ka nxitur jo pak konflikte mes palëve, që thirren në të drejtën e pronës dhe trashëgimisë. Por problemi nuk i takon vetëm së kaluarës, pasi edhe sot një praktikë e tillë është e pranishme. Kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së dokumentacionit, por edhe për t'u ikur pagesës së taksave në rastin e lidhjes së kontratës.